



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 146

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 15 tetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 56/2018 datë 6.9.2018	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, ‘Për buxhetin e vitit 2018’” 9709
Ligj nr. 58/2018 datë 20.9.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II..... 9709
Ligj nr. 59/2018 datë 20.9.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”..... 9713
Ligj nr. 60/2018 datë 20.9.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014..... 9718
Ligj nr. 61/2018 datë 20.9.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave..... 9719
Ligj nr. 64/2018 datë 24.9.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”... 9725
Ligj nr. 65/2018 datë 24.9.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar..... 9726

Ligj nr. 66/2018 datë 24.9.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë.....	9727
Vendim i Kuvendit nr. 106/2018, datë 11.10.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.....	9739



LIGJ
Nr. 56/2018

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË
26.7.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 109/2017, ‘PËR
BUXHETIN E VITIT 2018’”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 26.7.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, ‘Për buxhetin e vitit 2018’”.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratur në datën 6.9.2018

LIGJ
Nr. 58/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCE DHE
EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW) PËR PROGRAMIN E
REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SIPAS
PARIMIT TË EFICIENCËS SË
ENERGJISË, FAZA II**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar

nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për financimin e programit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II, me një grant në shumën prej 2 032 179,23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje njëzet e tre) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 20.9.2018

**Shpallur me dekretin nr. 10892, datë
10.10.2018 të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta**

MARRËVESHJE FINANCIARE
DATË 19.12.2017, NDËRMJET KfW
FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI),
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCE DHE EKONOMISË,
2,032,179.23 EURO
- PROGRAMI I REHABILITIMIT TË
KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË
TIRANËS, SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS
SË ENERGJISË, SHQIPËRI, FAZA II - BMZ-
NR. 2016 67 526

Bazuar në marrëveshjen e datës 2 maj 2017, e cila ende nuk ka hyrë në fuqi, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin “Programi për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas primeve të eficiencës energjetikë, faza II” (Marrëveshje Qeveritare), Marrësi dhe KfW-ja bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do të japë një kontribut financiar për Marrësin në një vlerë që nuk kalon 2,032,179.23 euro.



Ky kontribut financiar nuk do të shlyhet, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi, i cili në këtë aspekt përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“Ministria Zbatuese e Programit” ose “MZP”), do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për Rehabilitimin, sipas parimeve të eficiencës energjetike të konvikteve të Universitetit të Tiranës, faza II (Programi) dhe kryesisht për të financuar kostot e kursit të këmbimit. MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e Programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë për të cilën do të merret miratimi i Marrësit të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që mund të krijohen nga Marrësi dhe taksat doganore për importet nuk duhet të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2 Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Programit dhe bazuar në kërkesën e Marrësit, e cila në këtë rast përfaqësohet nga MZP-ja. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të miratohet nga Marrësi, MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurat e disbursimit, në veçanti faktet që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë disbursimin e fondeve pas datës 30 dhjetor 2021 ose ndonjë datë tjetër për të cilën është rënë dakord ndërmjet dy palëve.

Neni 3 Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, me përjashtim të rasteve, kur:

a) Marrësi nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat brenda afatit;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që lidhet me këtë Marrëveshje;

c) Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk është i aftë të provojë se të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) Përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje bie ndesh me ligjin e zbatueshëm; ose

e) Krijohen rrethana të jashtëzakonshme, të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

3.2 Nëse ka ndodhur ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1(b), (c) ose (d) dhe nuk është arritur të eliminohen brenda një afati kohor të përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të:

a) Kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara në rastin e parashikuar në nenin 3.1(b);

b) Në rastin e parashikuar në nenin 3.1(c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të ndonjë shume për të cilën Marrësi nuk është i aftë të provojë që është përdorur sipas qëllimit të përcaktuar;

c) Në rastin e parashikuar në nenin 3.1(d), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave, pagesa e të cilave për Marrësin ose në emër të Marrësit përbën shkelje të ligjit të zbatueshëm.

Neni 4 Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi duhet të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që krijohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë dhe që lidhen me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe të konvertimit që lidhen me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 5 Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe çdo person i emëruar nga ai ose ajo te KfW-ja dhe i autorizuar nga modeli i nënshkrimit të vërtetuar nga ai ose ajo, duhet të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe çdo person i emëruar nga ai ose ajo do të përfaqësojnë Marrësin gjatë zbatimit të Programit. Kompetencat e përfaqësimit nuk do të



përfundojnë deri në momentin që është kryer revokimi i tyre nga përfaqësuesi i autorizuar i Marrësit në momentin që ky revokim është marrë nga KfW-ja.

5.2 Shtesat ose amendimet e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e palëve kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim ose deklaratë që merret ose ka arritur në adresat e mëposhtme të palëve përkatëse kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese, siç i është njoftuar paraprakisht palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt
am Main
Republika Federale
e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-
2944

Për marrësin:
Republika
e Shqipërisë
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët
e Kombit”, nr. 3
Tiranë
Faks: +355 42 228494

Neni 6 Programi

6.1 Marrësi, në këtë rast i përfaqësuar nga MZP-ja:

a) Do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe ruajë përputhshmërinë e Programit me praktikën më të mira financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e Programit, siç është rënë dakord ndërmjet MZP-së dhe KfW-së;

b) Do të caktojë inxhinier këshillues të kualifikuar dhe të pavarur për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, si dhe një firmë të kualifikuar për zbatimin e Programit;

c) Do të lidhë kontrata për mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi financiar pasi të jenë kryer procedurat konkurruese ndërkombëtare të ofertimit;

d) Do të garantojë financimin e plotë të Programit dhe me kërkesën e KfW-së, do t'i

dërgojë KfW-së të dhëna që provojnë se janë mbuluar kostot që nuk janë paguar nëpërmjet kontributit financiar;

e) Do të ruajë ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe dokumenteve që tregojnë haptazi të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Programin, duke treguar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) Do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojnë këta libra dhe dokumente dhe secilin ose të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me zbatimin dhe operimin e Programit, si dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

g) Me kërkesë të KfW-së, do të dërgojë pranë KfW-së, duke i dërguar një kopje edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ndonjë ose të gjithë informacionin dhe raportet mbi Programin dhe progresin e tij; dhe

h) Me nismën e vet, do të informojë në kohë KfW-në për secilën ose të gjitha situatat që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

6.2 MZP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 6.1 në Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të miratohet nga Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

6.3 Për transportin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga kontributi financiar do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Marrësin.

Neni 7

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Programin

7.1 Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtare për transparencë maksimale dhe eficiencë në zhvillim dhe bashkëpunim, KfW-ja publikon informacion të zgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/t e lidhur/a me Programin janë zbatuar edhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “E gjithë periudha”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për zonën e tij të biznesit “KfW Development Bank”



(<http://transparenz.kfwentwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (si nga KfW-ja ose palët e treta në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën se si është financuar, nuk do të përfshijë dokumentacion kontraktues ose informacion sensitiv financiar ose të detajuar, në lidhje me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose financimin e tij, të tilla si:

- a) Informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) Strategjitë e biznesit;
- c) Udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) Të dhëna personale të personave fizikë;
- e) Klasifikimi i brendshëm i KfW-së mbi pozicionin financiar të palëve.

7.2 KfW-ja shpërndan informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet e përcaktuara më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe eficiencë:

- a) Filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe institucionet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë dhe filialet;
- c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillimin, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;
- d) Organizata ndërkombëtare të përfshira në grumbullimin e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Bashkëpunimin për Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë ka kërkuar nga KfW-ja që të ndajë me të informacion të zgjedhur për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës me subjektet në vijim, të cilat publikojnë seksionet përkatëse sipas qëllimit:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/we_ge/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

- b) Tregto dhe Investo në Gjermani (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

- c) OECD-ja për qëllime të raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të të gjithë bashkëpunimit gjerman në kuadër të zhvillimit për të siguruar transparencë dhe eficiencë (<http://www.deval.org/de/>).

7.4 Më tej, KfW-ja ruan të drejtën të transferojë te palët e treta, për sa kohë janë ruajtur interesat e ligjshëm (dhe për qëllime publikimi) informacion për Programin dhe mënyrën se si është financuar gjatë të gjithë periudhës.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit mbi informacionin që nuk do të transferohet nuk balançojnë interesat e KfW-së, nëse transferohet. Interesat e ligjshëm të Marrësit përfshijnë konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përcaktuar në nenin 7.1, i cili është i përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacionin te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave rregullore ose statutore ose për të pohuar, ose për të mbrojtur ndaj ankesave, ose çdo të drejtë tjetër ligjore para gjykatës ose procedurave administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, do të garantojë që personat e ngarkuar prej tij për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, lidhjen e kontratës për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen dhe që kërkojnë disbursimin e shumave të kontributit financiar nuk do të kërkojnë, pretendojnë, pranojnë, premtojnë ose marrin një premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera që lidhen me detyrat që kanë.

8.2 Marrësi, nëpërmjet MZP-së, nuk do të kryejë transaksione ose angazhohet në aktivitete të tjera që lidhen me Programin, të cilat do të përbënin shkelje të embargoeve që rregullojnë tregtinë ndërkombëtare ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian ose Republikës Federale të Gjermanisë.



8.3 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që do të shkaktohet nga ky fakt do të plotësohet nga dispozita që janë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.4 Marrësi nuk duhet të caktojë ose transferojë, të lërë peng ose si garanci çdo të drejtë të lindur nga kjo Marrëveshje.

8.5 Për këtë Marrëveshje do të zbatohet ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i ekzekutimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë në fund të kohëzgjatjes së Programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.7 Kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi sapo të jenë përmbushur kushtet në vijim: i. KfW-ja ka marrë njoftimin me shkrim nga Marrësi se procedurat e brendshme ligjore për t'u përmbushur nga Marrësi kanë përfunduar; dhe ii) Marrëveshja Qeveritare ka hyrë në fuqi dhe efekt të plotë.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
në datën 19 dhjetor 2017
KfW

Tiranë,
në datën 19 dhjetor 2017
Republika e Shqipërisë, e
përfaqësuar nga Ministria
e Financave dhe
Ekonomisë

LIGJ Nr. 59/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (GIZ) PËR PROJEKTIN “KËSHILLIMI PËR MIGRACIONIN NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI: Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.9.2018

Shpallur me dekretin nr. 10893, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

**MARRËVESHJE ZBATIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË, TIRANË, SHQIPËRI, MË
POSHTË REFERUAR SI “MFE” DHE
AGJENCISË GJERMANE PËR
BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR
(GIZ) *DAG-HAMMARSKJOLD-WEG* 1–5,
65760 ESCHBORN, MË POSHTË
REFERUAR SI “GIZ”, NË LIDHJE ME
PROJEKTIN “KËSHILLIMI PËR
MIGRACIONIN NË SHQIPËRI” (NË
KONTEKSTIN E PROGRAMIT GLOBAL”
MIGRACIONI PËR ZHVILLIM” (PME)), MË
POSHTË REFERUAR SI “PROJEKTI”**

Përmbajtja

Baza e Marrëveshjes

1. Objektivi i projektit dhe treguesit
2. Kontributet për Projektin nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Sigurimi i ekspertëve

Furnizimi me materiale dhe pajisje

Kostot operative dhe administrative

Kontribute të tjera



3. Kontributet për Projektin nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sigurimi i ekspertëve dhe i personelit ndihmës
Kostot

Sigurimi i ambienteve, ndërtesave dhe mjediseve të punës

Kontribute të tjera

4. Dispozita të tjera

Vlerësimi

Komiteti Drejtues

Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

Afati i Marrëveshjes

Rregullimi i Marrëveshjes

Forma e shkruar

Marrëveshjet me organizatat zbatuese të veçanta

Marrëveshjet Qeveritare

Hyrja në fuqi, kopjet

Baza e Marrëveshjes

Sa më poshtë vijon përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim teknik, të datës 21 tetor 1988 (shih shtojcën 1);

- Rezultatet e bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, në datën 12 korrik 2016 (shihni procesverbalin përmbledhës të bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, në datën 12 korrik 2016, shtojca 2).

Detajet e Projektit janë parashtruar në këtë marrëveshje zbatimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

GIZ-i vepron në zbatim të detyrës së ngarkuar nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

1. Objektivi i projektit dhe treguesit

Informacion paraprak për Projektin: Programi global, “Migracioni për zhvillim” (PME) është autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe po zbatohet nga Qendra për Migracion dhe Zhvillim (CIM) - veprimtari e përbashkët e *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* Shërbimet Ndërkombëtare dhe të Specializuara të Gjetjes së Punësimit (ZAV) të Agjencisë Federale Gjermane të Punësimit (*Bundesagentur für Arbeit, BA*).

Objektivi kryesor i Programit është forcimi i kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere. Ky objektivi po ndiqet në mënyrë aktive në pesë fusha veprimtare:

1. Këshillimi për politikën e migracionit: kuadrot e politikës për migracionin e ligjshëm dhe kontributet zhvillimore të migracionit po përmirësohen me anë të një këshillimi të strukturuar politikash që rrit koherencën politike, kapacitetin institucional dhe bashkëpunimin, si dhe dialogun.

2. Këshillimi për migracionin: po rritet mundësia e marrjes së informacionit mbi rrugët ligjore të migracionit për migrantët e mundshëm, me anë të këshillimit për migracionin; marrja e informacionit në lidhje me perspektivat e arsimimit dhe të tregut të punës po rritet për migrantët e mundshëm dhe të kthyer.

3. Kthimi i migrantëve i orientuar nga zhvillimi: migrantët e kthyer kontribuojnë për zhvillimin e vendeve të tyre përmes transferimit të njohurive. Po lehtësohet kthimi dhe riintegrimi.

4. Bashkëpunimi me diasporën: ndikimi zhvillimor i diasporës në vendin e tyre të origjinës po forcohet përmes bashkëpunimit me diasporën.

5. Ide biznesi për zhvillim: migrantët marrin këshillim efektiv dhe kualifikohen për të zbatuar ide biznesi në vendin e tyre të origjinës.

Që prej 23 dhjetorit 2015, Programi është autorizuar nga BMZ-ja për të zgjeruar veprimtaritë e tij në Republikën e Shqipërisë dhe, në veçanti, komponentin e saj, “Këshillim për migracionin” në bashkëpunim me MFE-në.



Aspektet e “Këshillimit për politikën e migracionit” do të integrohen, gjithashtu, në këtë bashkëpunim.

Objekti i komponentit të PME-së “Këshillimi për Migracionin” është lufta kundër migracionit të parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar për arsimin dhe formimin profesional, si dhe perspektivat e tregut të punës në Gjermani dhe në Shqipëri. Komponenti do të realizohet në Shqipëri në kuadër të Projektit të bashkëpunimit ndërmjet GIZ-it dhe MFE-së, për përmbajtjen e të cilit u ra dakord gjatë një seminari bashkëpunues, i cili u zhvillua në Tiranë, më 23 mars 2016.

Treguesit e komponentit dhe projektit të bashkëpunimit janë:

- Sportelet e migracionit ofrojnë këshillim për migracionin dhe punësimin në mënyrë të suksesshme;

- 2000 persona këshillohen çdo vit në qendrat e këshillimit (për t'u përcaktuar përgjatë vitit të parë të zbatimit);

- 60% të 2000 personave të këshilluar personalisht shprehin se do të rekomandonin shërbimet e këshillimit të qendrave të kërkues të tjerë shërbimesh (për t'u përcaktuar përgjatë vitit të parë të zbatimit);

GIZ-i dhe MFE-ja u përkushtohen bashkërisht këtij objekti.

2. Kontributet për projektin nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it

Në përputhje me “Procesverbalin përmbledhës të bisedimeve”, në lidhje me Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, në datën 12 korrik 2016, qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i ofrojë GIZ-it deri në 1,500,000 euro (1 milion e pesëqind mijë euro), për kontributin gjerman. Kjo shumë do të përfshijë edhe shpenzimet e kryera nga Organizata Zbatuese Gjermane.

Kohëzgjatja e projektit, sipas angazhimit të palës gjermane, është deri në datën 30.11.2020.

Sigurimi i ekspertizës

GIZ-i do të vërë në dispozicion për projektin:

- Deri në 4 punonjës të GIZ-it për të drejtuar dhe zbatuar projektin e bashkëpunimit, për të

zbatuar detyrat e dhënies së këshillimit grupit të synuar “migrantët që kërkojnë këshillim”, si dhe për të ngritur kapacitetet e personelit përkatës pranë MFE-së/SHKP-së. Një prej tyre do të jetë përgjegjës për kontributin e GIZ-it dhe do të kryejë njëkohësisht edhe funksionin e drejtuesit të ekipit të ekspertëve të vëna në dispozicion nga Projekti për kohëzgjatjen e fazës së përshkruar në klauzolën 4 më poshtë;

- Pjesërisht, duke nënkontraktuar punonjës të GIZ-it të sportelet e migracionit (SM)/SHKP, për masat e ngritjes së kapaciteteve;

- Lehtësimin deri në pesë trajnime për ngritjen e kapaciteteve të sporteleve të migracionit të SHKP-së, për sa i përket informimit për kanalet e migracionit për punësim, lehtësimin e shkëmbimit të përvojave (të mësuarit mes kolegësh), trajnimit të shumëfishuesve (punonjës të përzgjedhur nga ana e SHKP-së), me qëllim kualifikimin e personelit në drejtim të dhënies së këshillimit dhe shërbimeve këshillimore. Këto trajnime do të kryhen nga ana e Agjencisë Federale Gjermane të Punësimit mbi temat e mëposhtme: “Metodologjia bazë e këshillimit”; “Të Jetuarit dhe të punuarit në Gjermani”; “Akse si në tregun gjerman të punës”;

- Krijimi i një faqeje interneti, e cila përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për grupin e synuar, duke përfshirë personat e kontaktit dhe numrat e telefonit;

- Hartimi i një strategjie për marrëdhëniet me publikun për sportelet e migracionit të SHKP-së;

- Zhvillimin e kontributeve teknike dhe koordinimin e aktiviteteve, të cilat janë ende për t'u përcaktuar; lehtësimin e misionëve të ekspertëve afatshkurtër mbi aktivitetet e përmendura më sipër, si dhe çështje të mëtejshme për t'u caktuar për një periudhë deri në 100 ditë në total.

- Zhvillimi i deri në 4 aktivitete për formimin e rrjeteve dhe shkëmbimin e informacioneve për grupin e synuar;

- Përgatitjen e një dokumenti strategjik për MFE-në të politikëbërjes për migracionin e punësimit të orientuar ndaj zhvillimit

- Trajnimin e punonjësve të MFE-së në lidhje me dispozitat dhe zbatimin e strategjisë

Furnizimi me materiale dhe pajisje

GIZ-i do të ofrojë artikujt e mëposhtëm për pajisjen e infrastrukturës teknike:



- 1 automjet për projektin;
- Pajisje të teknologjisë së informacionit për zyrat pilot;
- Përditësimin, faqosjen dhe printimin e informacionit për migrimin në Gjermani dhe rregullat e akse sit në tregun e punës në Gjermani për shtetasit e vendeve të treta;
- Manual pune për punonjësit e sporteleve të migracionit me fokus në metodat e këshillimit.

Kostot operative dhe administrative

GIZ-i do të mbulojë shpenzimet operative dhe/ose administrative që shoqërohen me përmbushjen e kontributit gjerman për Projektin.

Kontribute të tjera

GIZ-i do të japë edhe kontributet e mëtejshme shtesë:

- Kontributet financiare dhe/ose mbështetje në konferenca, takime pune ose seminare në lidhje me çështjet e migrimit për punësim;
- Kontribute të tjera në përputhje me planin e veprimeve, ende për t'u miratuar.

3. Kontributet për Projektin nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet MFE-së

Sigurimi i ekspertëve dhe i personelit ndihmës

MFE-ja (duke përfshirë institucionet e varësisë) do të:

- Emërojnë deri në 4 punonjës të MFE-së, SHKP-së, sporteleve të migracionit për të marrë pjesë në grupin drejtues;
- Emërojnë të paktën 10 ekspertë homologë pranë MFE-së, SHKP-së dhe sporteleve të migracionit për personelin e nënkontraktuar të GIZ-it, ekspertët afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Sigurojnë punonjës të nivelit drejtues dhe administrativ në sportelet e migracionit të cilët iu nënshtrohen masave të ngritjes së kapaciteteve;
- Sigurojnë pjesëmarrjen e stafit të MFE-së dhe institucioneve në varësi në masat e ngritjes së kapaciteteve;
- MFE-ja krijon kushtet e mjaftueshme për të garantuar pjesëmarrjen e stafit në trajnime.

Kostot

MFE-ja do të:

- Sigurojë që kostot e specifikuar në planin e veprimeve do të buxhetohen në kohën e duhur;
- Marrë përsipër TVSH-në për aktivitetet e projektit, që përfitojnë institucionet respektive dhe shpenzimet që kryhen në Shqipëri (kostot operative dhe prokurimet), si edhe për

prokurimet/importet ndërkombëtare. Të sigurojë buxhet të mjaftueshëm deri në fund të projektit (11/2020). Rimbursimi i TVSH-së është i vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të projektit.

- Sigurojë një buxhet për të punësuar personel të mëtejshëm pranë sporteleve të migracionit/SHKP-së dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet operative dhe për personelin në lidhje me këtë.

Sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe ambienteve të punës

MFE-ja do të vërë në dispozicion të Projektit pa pagesë mjediset dhe ndërtesat e mëposhtme, duke përfshirë pajisjet dhe orenditë, duke pasur parasysh që pajisje apo orendi të tilla nuk janë siguruar nga GIZ-i: zyrat e sporteleve të migracionit dhe SHKP-së në rajonet pilot dhe më tej; hyrjen në sallën e konferencave në MFE, nëse është e nevojshme për aktivitete që lidhen me Projektin.

Kontribute të tjera

MFE-ja do të:

- Mbështesë bashkëpunimin me njësi të tjera kombëtare dhe rajonale të MFE-së në zbatimin e projektit, si dhe me njësi të tjera.

4. Dispozita të tjera

Vlerësimi

GIZ-i mund të ndërmarrë një vlerësim të Projektit gjatë ose pas zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ-i do të caktojë ekspertë/vlerësues të Projektit. MFE-ja do të marrë pjesë në vlerësim. Në të gjitha rastet, do të asistojë ekspertin/ët/vlerësuesin/t në punën e tyre dhe do t'i lejojë që të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MFE-ja do të informohet në lidhje me rezultatet e vlerësimit nëpërmjet një raporti.

Komiteti Drejtues

GIZ-i dhe MFE-ja, si dhe institucionet në varësi, veçanërisht sportelet e migracionit/SHKP-ja do të formojnë një Komitet Drejtues, i cili do të mbledhet minimalisht dy herë në vit, me qëllim monitorimin e zbatimit të Projektit, si dhe për të rënë dakord mbi ndryshimet e mundshme.

Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi i Marrëveshjes

GIZ-i mund të pezullojë kontributet e tij, nëse:

- MFE-ja nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet që lidhen me këtë Marrëveshje; ose



- Lindin rrethana që pengojnë ose vënë në rrezik të konsiderueshëm objektivin e Projektit të përshkruar në klauzolën 1 më lart.

Nëse lind një nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 më lart dhe nëse ekziston ende pas një afati kohor të dakordësuar nga GIZ-i me MFE-në ose nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ-i, me miratimin e qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund të mbyllë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje para afatit.

Afati i Marrëveshjes

Përveç kur parashikohet në klauzolën 4 më lart në lidhje me pezullimin e kontributeve dhe përmbylljen e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit deri më 30 nëntor 2020. Afati i kësaj Marrëveshjeje mund të zgjatet, në rast të një vonese të ekzekutimit të kontributit gjerman, siç parashtrohet në këtë Marrëveshje dhe të ekzekutimit të kontributeve të dakordësuar të MFE-së. Zgjerimi i termave të kësaj marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga të dyja palët.

Amendimet e Marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk ndihmojnë për arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në klauzolën 1 më lart, atëherë GIZ-i dhe MFE-ja mund t'i përshtatin ose amendojnë këto dispozita me pëlqim të përbashkët në çdo fazë gjatë zbatimit të Projektit. Çdo amendim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme nëse detyra me të cilën është ngarkuar nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë tërhiqet/anulohet.

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet rreth interpretimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nga GIZ-i dhe MFE-ja. Në rast se brenda një afati prej tre muajsh, nuk do të mund të gjejnë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen përmes bisedimeve nëpërmjet kanaleve diplomatike mes dy qeverive, deri në fund të muajit pasardhës.

Forma me shkrim

Amendimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje, dhe çdo deklaratë tjetër e rëndësishme apo komunikime të një rëndësie për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të bëhen më shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, është e

mjaftueshme që të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion.

Marrëveshjet me organizata zbatuese të veçanta

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ-i dhe personi/personat përgjegjës për kontributet nga organizata partnere ose nga organizata të tjera zbatuese, mund të lidhin bashkërisht një marrëveshje detyruese për detajet shtesë që lidhen me zbatimin e Projektit (p.sh., në bazë të planit të veprimeve) ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme t'i shënojnë ato detaje me shkrim dhe, kur është e nevojshme, t'i përshtatin një marrëveshje të tillë, duke marrë në konsideratë zhvillimet në Projekt.

Marrëveshjet qeveritare

Për sa i përket pjesës tjetër, dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim teknik (shihni shtojcën 1) dhe "Procesverbalit të bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, në datën 12 korrik 2016, shtojca 2, të cilave iu referohemi në fillim të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen edhe për këtë Marrëveshje.

Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore, të parashikuara nga ligji nr. 43/2016, "Për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Marrëveshja hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe të dyja tekstet janë autentike me fuqi të barabartë.

Në emër të Republikës së Shqipërisë
Arben Ahmetaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Në emër të Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)
Hans-Jürgen Cassens
Drejtori për Shqipërinë

Koordinatori Kombëtar për PME-në
Florenc Qosja



LIGJ
Nr. 60/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH
QË PËR DITËSON MARRËVESHJEN
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË
EVROPIANE (EUROPOL) PËR
BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE
OPERACIONAL, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 28/2014

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.9.2018

Shpallur me dekretin nr. 10894, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



DREJTORI EKZEKUTIV

Lënda: Propozim mbi përditësimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit

I nderuar zoti ministër/shkëlqesi,

Siç mund të jeni informuar, kuadri ligjor i Europolit ka ndryshuar si rezultat i hyrjes në fuqi të Rregullores së re në maj të këtij viti. Mandati i Europolit mbulon veprat penale të cilat lidhen

me krimet e rënda që prekin dy ose më shumë vende të Bashkimit Evropian, terrorizmin dhe format e tjera të krimit që prekin një interes të përbashkët të mbuluar nga një politikë e Bashkimit Evropian, siç renditet në shtojcën 1 të Rregullores së Europolit, një kopje të së cilës do ta gjeni në materialin bashkëlidhur.

Në këtë kontekst, me anë të kësaj letre, propozoj përditësimin e qëllimit të Marrëveshjes për Bashkëpunimin Strategjik dhe Operacional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, të nënshkruar në Hagë më 9.12.2013, me të gjitha fushat e krimit që janë renditur në shtojcën të Rregullores së Europolit, me anë të shkëmbimit të dokumenteve siç theksohet në nenin 25 të Marrëveshjes. Nëse ky propozim do të ketë miratimin tuaj, kam nderin të sugjeroj që kjo letër së bashku me pranimin në formë të shkruar, të përbëjë një Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit për përditësimin e qëllimit të marrëveshjes sonë.

Ky përditësim, në rast se ju pranoni, do të zbatohet në datën kur Europol do të marrë miratimin tuaj me shkrim.

Europol i përfiton nga kjo mundësi për të përsëritur sigurinë e konsideratës më të lartë.

Me respekt,
Rob Wainwright
Drejtore Ekzekutive

Lënda: Përditësim mbi qëllimin e Marrëveshjes sonë të Bashkëpunimit

I nderuar zoti drejtor ekzekutiv,

Kam nderin të pranoj marrjen e letrës suaj, të datës ____, në të cilën propozoni të përditësoni fushën e bashkëpunimit tonë në të gjitha fushat e krimeve të renditura sipas shtojcës I të rregullores së Europolit.

Kam nderin të konfirmoj që Republika e Shqipërisë pranon propozimin tuaj dhe, gjithashtu, bie dakord se letra juaj dhe kjo përgjigje përbëjnë një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit në lidhje me përditësimin e fushës së Marrëveshjes sonë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 25 të saj.

Sipas propozimit tuaj, unë e konsideroj përditësimin e qëllimit të Marrëveshjes sonë të Bashkëpunimit që të ketë hyrë në fuqi me këtë letër.



Jam në pritje të vazhdimet, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit tonë ekzistues.

Me respekt,

LIGJ
Nr. 61/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E
DYTË TË FINANCIMIT PËR
PROJEKTIN E SIGURISË SË DIGAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.9.2018

Shpallur me dekreten nr. 10895, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

HUAJA NR. 8862-AL

**PROGRAMI I KOMUNITETIT
ENERGJETIK TË EVROPËS JUGLINDORE**

MARRËVESHJE HUAJE
(FINANCIMI I DYTË SHITESË PËR
PROJEKTIN E SIGURISË SË DIGAVE)
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

Marrëveshje, e lidhur në datën e nënshkrimit, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si vijon:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkufizohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen për këtë Marrëveshje dhe janë pjesë integrale e saj.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat që fillojnë me shkronjë të madhe në këtë marrëveshje kanë kuptimin e caktuar për to në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit shumë prej 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) eurosh (Huaja), për të ndihmuar financimin e projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund t'i tërheqë fondet e Huas sipas seksionit III, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa fillestare është sa një e katërta e një për qind (0,25%) të shumës së Huas.

2.04 Tarifa e Angazhimit është sa një e katërta e një për qind (0,25%) në vit të Tepricës së Patërhequr të Huas.

2.05 Norma e interesit është Norma e Referimit plus një Marzh i Pandryshueshëm në bazë të pikës 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e Shlyerjes janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.



2.07 Principali i Huas do të shlyhet sipas tabelës së amortizimit që jepet në skedulën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III
Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit dhe të Programit. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr masat që Projekti të zbatohet nga Subjekti Zbatues i Projektit, sipas dispozitave të nenit V, të Kushteve të Përgjithshme, skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit.

Neni IV
Mjetet ligjore të bankës

4.01 Rasti Shtesë i Pezullimit konsiston në sa më poshtë, pra që është ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë nga Legjislacioni i Subjektit Zbatues të Projektit, në atë mënyrë që cenon në mënyrë materiale dhe të pafavorshme, sipas mendimit të Bankës mundësinë e Subjektit Zbatues të Projektit, për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij që i lindin nga Marrëveshja e Projektit.

Neni V
Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01 Kushtet shtesë për hyrjen në fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) Është lidhur Marrëveshja e Nënhuas në emër të Huamarrësit dhe të Subjektit Zbatues të Projektit.

b) Është shpallur hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit.

5.02 Çështja tjetër, e përmendur në pikën 9.02(a)(ii) të Kushteve të Përgjithshme, konsiston në pikën që Marrëveshja e Nënhuas është autorizuar rregullisht nga Huamarrësi dhe Subjekti Zbatues i Projektit dhe ka fuqi detyruese ligjore për Huamarrësin dhe mbi Subjektin Zbatues të Projektit, në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Afati për hyrjen në fuqi është data 90 (nëntëdhjetë) ditë pas Datës së Nënshkrimit të Marrëveshjes.

Neni VI
Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

6.02 Për qëllime të Pikës 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: a) Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Nr. 3, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa Elektronike e Huamarrësit është:

Faksimile: Posta elektronike:
355-4222- sekretariamin@financa.gov.al
8494

6.03 Për qëllime të pikës 10.01 të Kushteve të Përgjithshme: a) Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America (Shtetet e Bashkuara të Amerikës); dhe

b) Adresa Elektronike e Bankës është:

Teleks: Faksimile: Posta elektronike:
248423 1-202- msalim1@worldbank.org
(MCI) 477-6391

ose

64145

(MCI)

Rënë dakord në datën e nënshkrimit.

PËR SHQIPËRINË

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: ARBEN AHMETAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCave DHE
EKONOMISË

Data 21.6.2018

PËR BANKËN NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: MARYAM SALIM

Titulli: MENAXHER I VENDIT

Data 21.6.2018



SKEDULI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivat e Projektit janë: i. dhënia e kontributit për sigurinë e digave hidroenergjetike në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat në territorin e Huamarrësit; dhe ii. përmirësimi i efikasitetit të shfrytëzimit të këtyre digave hidroenergjetike dhe rritja e qëndrueshmërisë së furnizimit të energjisë në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Projekti përbën fazën e pestë të Programit dhe konsiston në pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Investime në infrastrukturën e sigurisë së digave

1. Sigurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve për masat korrigjuese me prioritet shumë të lartë për digat, duke përfshirë: a) rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë të Hidrocentralit të Fierzës; dhe b) rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë të Hidrocentralit të Komanit.

2. Sigurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve për masat korrigjuese me prioritet të lartë për digat, duke përfshirë: a) rehabilitimin e pajisjeve elektromekanike të Hidrocentralit të Komanit; dhe b) modernizimin dhe përmirësimin e departamentit të sigurisë së digave të Subjektit Zbatues të Projektit.

Pjesa 2. Asistencë teknike dhe trajnim për sigurinë e digave

1. Sigurimi i shërbimeve Subjektit Zbatues të Projektit për të vënë në zbatim një qasje të menaxhimit të integruar të burimeve ujore për menaxhimin e ujëmbledhësve lumorë të Drinit dhe të Matit, si edhe për optimizimin e prodhimit të energjisë dhe menaxhimit të burimeve ujore.

2. Sigurimi i shërbimeve të konsulentëve për ta asistuar Subjektin Zbatues të Projektit me aktivitetet e prokurimit, projektimit dhe mbikëqyrjes në kuadër të Projektit.

3. Sigurimi i shërbimeve të konsulentëve për përmirësimin e kapacitetit të menaxhimit financiar të Subjektit Zbatues të Projektit.

4. Sigurimi i shërbimeve të konsulentëve për Panelin e Ekspertëve të pavarur.

SKEDULI 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

SEKSIONI I MASAT ZBATUESE

A. Marrëveshja e Nënhuas

1.a) Për të ndihmuar në realizimin e Projektit, Huamarrësi ia vendos fondet e Huas në dispozicion Subjektit Zbatues të Projektit, në bazë të një Marrëveshjeje Nënhuaje ndërmjet Huamarrësit dhe Subjektit Zbatues të Projektit (Marrëveshja e Nënhuas), sipas kushteve të miratuara nga Banka, e cila përfshin dispozitat e mëposhtme.

b) Fondet e Nënhuas: a) Janë në valutën euro dhe shlyhen po me këtë monedhë; b) Janë objekt interesi mbi shumën e principalit të tërhequr dhe ende të pashlyer herë pas here, në përputhje me seksionin 2.05 të kësaj Marrëveshjeje; c) Shlyhen në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje; d) Tarifa e Angazhimit është sa një e katërta e një për qind (0.25%) në vit të Tepicës së Patërhequr të Nënhuas; dhe e) Tarifa fillestare është sa një e katërta e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2. Huamarrësi i ushtron të drejtat që i rrjedhin nga Marrëveshja e Nënhuas, në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Bankës Botërore dhe të përmbushë qëllimet e Huas. Nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk e delegon, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë nga Marrëveshja e Nënhuas apo dispozita të saj.

B. Masat mbrojtëse

a) Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, siguron që Subjekti Zbatues i Projektit:

i. ta zbatojë Projektin në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor, në të cilin Huamarrësi nuk e ndryshon, pezullon, anulon, shfuqizon apo heq dorë nga ndonjë dispozitë pa miratimin paraprak të Bankës; dhe

ii. të sigurojë që e gjithë asistencë teknike në kuadër të Projektit të zhvillohet vetëm në përputhje me termat e referencës të shqyrtuar dhe të konstatuar si të pranueshëm nga Banka, terma reference të cilët sigurojnë që asistencë teknike merr në konsideratë dhe kërkon zbatimin e Politikave Mbrojtëse të Bankës.

b) *Siguria e digave*

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, siguron në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit që Subjekti Zbatues i Projektit:

i. të mbajë Panelin e Ekspertëve të Sigurisë së Digave, me kualifikimet, burimet dhe përvojën e pranueshme për Bankën, Panel i cili është përgjegjës për ta këshilluar Huamarrësin për çështje të lidhura me sigurinë e digave që rehabilitohen në kuadër të pjesës I të Projektit; duke përfshirë shqyrtimin e projekteve dhe studimeve për rehabilitimin e digave në fjalë, dhe monitorimin, dhe raportimin e punimeve rehabilituese të këtyre digave dhe përfundimin e punimeve përkatëse;

ii. përpara fillimit të tenderimit të punimeve që do të realizohen në kuadër të Projektit:

A. Të përgatisë ose të sigurojë përgatitjen, në përputhje me një kuadër të pranueshëm për Bankën, plane të hollësishme dhe me afate kohore, në lidhje me digat në fjalë: 1. Për mbikëqyrjen e ndërtimeve dhe kontrollin e cilësisë; 2. Për instrumentet; 3. Për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen; dhe 4. Planin e Gatishmërisë për Situatat e Jashtëzakonshme; dhe

B. T'i finalizojë planet e lartpërmendura apo të sigurojë finalizimin e tyre, duke marrë në konsideratë komentet e Bankës për to.

Pas kësaj, zbaton ose siguron zbatimin e këtyre planeve siç janë pranuar nga Banka; dhe

iii. pas përfundimit të punimeve ndërtimore në digat e lartpërmendura, merr profesionistë të pavarur e të kualifikuar për të kryer kontrollet periodike të sigurisë për digat e lartpërmendura.

c) *Mekanizmi për trajtimin e ankesave*

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, mban dhe bën publik ose i kërkon Subjektit Zbatues të Projektit të mbajë dhe të bëjë publik, gjatë të gjithë zbatimit të Projektit një mekanizëm për trajtimin e ankesave, me formën dhe përmbajtjen e pranueshme për Bankën, i cili duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë me rregullsi dhe në mirëbesim të gjitha ankesat e bëra në lidhje me Projektin dhe merr, vetë ose nëpërmjet Subjektit Zbatues të Projektit, të gjitha masat e nevojshme për t'i vënë në zbatim vendimet e marra nga ky mekanizëm, sipas mënyrës që është e pranueshme për Bankën.

SEKSIONI II MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI I PROJEKTT

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, siguron që Subjekti Zbatues i Projektit t'i vërë në dispozicion Bankës çdo Raport Projekti jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas fundit të çdo gjashtëmujori kalendarik, në të cilin mbulohet gjashtëmujori kalendarik.

SEKSIONI III PROKURIMI

A. Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet. Të gjitha mallrat dhe punimet që janë të nevojshme për Projektin dhe që duhen financuar me fondet e Huas prokurohen sipas kërkesave të parashikuara ose të përmendura në seksionin 1 të Udhëzimeve për Prokurimin dhe dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që janë të nevojshme për Projektin dhe që duhen financuar me fondet e Huas prokurohen sipas kërkesave të parashikuara ose të përmendura në seksionin 1 dhe seksionin IV të Udhëzimeve për Konsulentët dhe dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat që fillojnë me shkronjë të madhe dhe që përdoren në pikat e mëposhtme të këtij seksioni për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metodat e shqyrtimit që Banka zbaton për kontrata të veçanta, bazohen në metodën përkatëse të përshkruar, sipas rastit, në seksionin II dhe seksionin III të Udhëzimit për Prokurimin ose në seksionet II, III, IV dhe V të Udhëzimit për Konsulentët.

B. Metodatat e veçanta të prokurimit të mallrave dhe punimeve

1. Tenderimi konkurrues ndërkombëtar. Nëse nuk parashikohet ndryshe në pikën 2 më poshtë, mallrat dhe punimet prokurohen me kontrata të lidhura në bazë të tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

2. Metodatat e tjera të prokurimit të mallrave dhe punimeve. Tabela në vijim përcakton metodatat e prokurimit, që nuk përfshijnë tenderimin konkurrues ndërkombëtar, të cilat mund të përdoren për mallrat dhe punimet. Plani



i Prokurimeve përcakton rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Blerje në treg

C. Metodatat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja sipas cilësisë dhe koston. Nëse nuk parashikohet ndryshe në pikën 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen me kontrata të lidhura në bazë të përzgjedhjes sipas cilësisë dhe koston.

2. Metodatat e tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Tabela në vijim përcakton metodatat e prokurimit, që nuk përfshijnë përzgjedhjen sipas cilësisë dhe koston, të cilat mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i Prokurimeve përcakton rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhja në bazë të cilësisë
b) Përzgjedhja me koston më të ulët
c) Përzgjedhja nga një burim i vetëm i firmave të konsulentëve
d) Përzgjedhja në bazë të kualifikimeve të konsulentëve

e) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të udhëzimeve për përzgjedhjen e konsulentëve individualë

D. Shqyrtimi i vendimeve të prokurimit nga Banka Botërore

Të gjitha kontratat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka.

SEKSIONI IV

TËRHEQJA E FONDEVE TË HUAS

A. Të përgjithshme.

Pa kufizuar dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Shkresën për Informacionin mbi Livrimin dhe Financat, Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas: a) për të financuar Shpenzimet e Lejuara; dhe b) për të paguar Tarifën Fillestare; sipas shumës së caktuar dhe, nëse zbatohet, deri në përqindjen e përcaktuar kundrejt secilës kategori të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e Huas e caktuar (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (nuk përfshin tatimet)
1. Mallrat dhe punimet për pjesën 1.1(a), pjesën 1.2(a), pjesën 1.2(b), pjesën 2.2, pjesën 2.3 dhe pjesën 2.4 të Projektit dhe shërbimet e konsulentëve për pjesën 2.2, pjesën 2.3 dhe pjesën 2.4 të Projektit	10.370.000	100%
2. Mallrat dhe punimet për pjesën 1.1(b) të Projektit	1.600.000	20%
3. Tarifa fillestare	30.000	Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07(b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE	12.000.000	



B. Kushtet për tërheqjen; Periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të Pjesës A më lart, nuk mund të bëhet asnjë tërheqje për pagesat e kryera përpara Datës së Nënshkrimit.

2. Data e mbylljes është data 31 dhjetor 2020.

SKEDULI 3 GRAFIKU I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Në tabelën në vijim jepen datat e shlyerjes së principalit të huas dhe përqindja e shumës totale të principalit të huas të pagueshme në çdo datë shlyerjeje të principalit (Përqindja e kështit).

Shlyerja e principalit

Data e shlyerjes së principalit	Përqindja e kështit
Çdo 15 maj dhe 15 nëntor Fillon më 15 maj 2025 deri më 15 maj 2040	3,13%
Më 15 nëntor 2050	2,97%

SHTOJCË

SEKSIONI I PËRKUFIZIME

1. “Marrëveshja për Huan shtesë” ose “Marrëveshja AF1” është Marrëveshja e Huas për Financimin e parë shtesë për Projektin e datës 17 shkurt 2012, e ndryshuar (Huaja nr. 8111-AL).

2. “Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha” është Komiteti i Digave të Mëdha i Huamarrësit, i krijuar në bazë të ligjit nr. 8681, i datës 11.2.2000, “Për mbrojtjen, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i ndryshuar.

3. “Udhëzimi kundër Korrupsionit” është “Udhëzimi për parandalimin dhe luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në projektet e financuara me hua të BNRZH-së dhe kredi e grante të SHNZH-së”, i datës 15 tetor 2006, i rishikuar në janar 2011.

4. “Kategoria” është një kategori e përcaktuar sipas tabelës në seksionin IV të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Bashkëfinancuesi” është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

6. “Bashkëfinancimi” është, për qëllime të pikës 16 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, sa vijon, pra shuma 6.100.000 euro që do të sigurohet nga Bashkëfinancuesi për të asistuar në financimin e Projektit.

7. “Marrëveshja e Bashkëfinancimit” është Marrëveshja e Bashkëfinancimit që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila parashikon që Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim siguron shumën 6.100.000 euro për të asistuar në financimin e Projektit.

8. “Udhëzimi për konsulentët” është “Udhëzimi: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore”, i publikuar nga Banka në maj 2011, i rishikuar në korrik 2014.

9. “Plani institucional për sigurinë e digave” është plani i datës 9 mars 2018, i miratuar nga Subjekti Zbatues i Projektit, ku trajtohen problemet e sigurisë së digave në lumin Drin dhe lumin Mat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.

10. “Plani i Gatishmërisë për Situatat e Jashtëzakonshme” është plani i datës 27 shkurt 2017, i përgatitur nga Subjekti Zbatues i Projektit dhe i pranueshëm për Bankën, ku përcaktohen rolet e palëve përgjegjëse kur çmohet se ka rrezik të menjëhershëm për një rënie të digave ose kur shkarkimi i prituri operativ i prurjeve rrezikon jetën, pronat ose operacionet ekonomike në rrjedhën e poshtme të digave të cilat varen nga nivelet e prurjeve lumore.

11. “Plani i Menaxhimit Mjedisor” është plani i miratuar nga Huamarrësi më 15 maj 2008, i pranueshëm për Bankën, i cili konsiston në një tërësi masash zbutjeje, monitorimi dhe institucionale që duhen marrë për të eliminuar efektet e padëshirueshme mjedisore dhe sociale, për t’i balancuar apo për t’i zvogëluar në nivele të pranueshme, si edhe veprimet e nevojshme për t’i vënë në zbatim këto masa, me përditësimet e bëra herë pas here me miratimin paraparak të Bankës.

12. “Kushtet e Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimet e dhëna nga BNRZH-ja, financimi i projekteve të



investimeve” i datës 14 korrik 2017, me ndryshimet e parashikuara në seksionin II të kësaj shtojce.

13. “Marrëveshja fillestare” është Marrëveshja e Financimit për Projektin e Sigurisë së Digave, e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, më 2 korrik 2008, e ndryshuar (Kredia nr. 4480);

14. “Paneli i Ekspertëve” është paneli i përbërë prej të paktën 3 ekspertëve nga fusha të ndryshme teknike, në lidhje me aspektet e sigurisë së digave të Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës dhe Shkopetit, i krijuar sipas termave të referencës të pranueshëm për Bankën dhe i cili është përgjegjës për shqyrtimin dhe dhënien e këshillave për Huamarrësin dhe Subjektin Zbatues të Projektit për çështjet e lidhura me sigurinë e digave dhe aspekte të tjera kritike/të rëndësishme të digave, strukturat e tyre përkatëse, zonat ujëmbledhëse, zonat përreth rezervuarit dhe zonat në rrjedhën e poshtme.

15. “Udhëzimi i Prokurimit” është Udhëzimi i Bankës për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente në kuadër të huave të BNRZH-së dhe kredive e granteve të SHNZH-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore, i muajit janar 2011 dhe i rishikuar në maj 2014.

16. “Plani i Prokurimit” është plani i prokurimit për Projektin, i datës 19 mars 2018, i përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzimit për Prokurimin dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimit për Konsulentët me përditësimet e bëra herë pas here nga Marrësi sipas dispozitave të paragrafëve të lartpërmendur.

17. “Programi” është programi i projektuar për të mbështetur Komunitetin Energjetik të Evropës Juglindore siç parashikohet në Traktatin e Komunitetit të Energjisë të datës 23 tetor 2005, nëpërmjet Huave Programore të Përshtatshme që u jepen vendeve anëtare të Bankës në Evropën Juglindore.

18. “Subjekti Zbatues i Projektit” është Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH), shoqëri tregtare e pavarur, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Subjektit Zbatues të Projektit.

19. “Legjislacioni i Subjektit Zbatues të Projektit” është ligji nr. 7926, i datës 20.4.1995, i Huamarrësit.

20. “Njësia e Menaxhimit të Projektit” është njësia e ngarkuar me menaxhimin e zbatimit të Projektit, e krijuar pranë Subjektit Zbatues të Projektit.

21. “Data e nënshkrimit” është më e fundit e dy datave në të cilat Huamarrësi dhe Banka kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha rastet kur përmendet “data e Marrëveshjes së Huas” në Kushtet e Përgjithshme.

22. “Marrëveshja e Nënhuas” është marrëveshja e përmendur në seksionin I.A, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje, sipas së cilës Huamarrësi ia vë fondet e Huas në dispozicion Subjektit Zbatues të Projektit.

SEKSIONI II NDRYSHIME NË KUSHTET E PËRGJITHSHME

Nëpërmjet këtij seksioni bëhen ndryshimet e mëposhtme në Kushtet e Përgjithshme:

1. Seksioni 5.13 (Prokurimi) hiqet plotësisht dhe pas kësaj pjesa tjetër e nenit V rinumërohet sipas rendit përkatës.

3. Pikat 84 (Plani i Prokurimit) dhe 85 (Rregulloret e Prokurimit) në shtojcë hiqen në tërësi dhe pikat e mëpasshme rinumërohen sipas rendit përkatës.

LIGJ Nr. 64/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 102/2015, “PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në pikën 2, të nenit 89, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, fjalë e parë ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.9.2018

Shpallur me dekretin nr. 10896, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

**LIGJ
Nr. 65/2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 8318, DATË 1.4.1998, “PËR
DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS
BUJQËSORE E PYJORE, TË
LIVADHEVE DHE KULLOTAVE QË
JANË PASURI SHTETËRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, paragrafi i tretë shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 16 shtohen nenet 16/1 dhe 16/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

1. Në rastet kur në tokat bujqësore në administrim të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, objekt i qiradhënies, qiramarrësi kërkon të ndërtojë objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet leje ndërtimi dhe kategoria e resursit ndryshon nga “tokë bujqësore” në “truall”, qiradhënësi mund

të japë miratimin, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Ndërtimi i objekteve të parashikuara në kërkesë të jetë në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit të territorit;

b) Sipërfaqja ndërtimore të shërbejë vetëm për objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, të tokës bujqësore, objekt i qiradhënies ose për ngritjen e objekteve ndërtimore në funksion të agroturizmit.

Nuk lejohet në asnjë rast ndryshimi i destinacionit të objektit të ndërtuar sipas këtij ligji.

2. Për sipërfaqen ndërtimore “truall”, të miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, aplikohet i njëjti çmim i qiradhënies si për tokën bujqësore.

Neni 16/2

1. Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në kontratë ose të mbarimit të afatit të qiradhënies, objekti ndërtimor, si dhe çdo investim tjetër i trupëzuar kalon në pronësi të qiradhënësit, pa shpërblim.

2. Në rastin kur në sipërfaqen ndërtimore dhe/ose në sipërfaqet e mbjella me kultura bujqësore parashikohet realizimi i një projekti, investimi apo objekti për interes publik, kompensimi i qiramarrësit për shpenzimet e kryera për objektin ndërtimor, si dhe çdo investim tjetër të trupëzuar, bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpronësimet për interes publik. Masa e kompensimit mbulohet nga entiteti përgjegjës për zhvillimin e projektit, investimit apo objektit që paraqet interes publik.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.9.2018

Shpallur me dekretin nr. 10897, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



LIGJ
Nr. 66/2018

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË AKTIN E GJENEVËS
TË MARRËVESHJES SË LISBONËS
PËR EMËRTIMET E ORIGJINËS DHE
TREGUESIT GJEOGRAFIKË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.9.2018

Shpallur me dekreten nr. 10898, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

AKTI I GJENEVËS
I MARRËVESHJES SË LISBONËS PËR
EMËRTIMET E ORIGJINËS DHE
TREGUESIT GJEOGRAFIKË

Lista e neneve

Kapitulli I. Hyrja dhe dispozita të përgjithshme

Neni 1. Shprehje të shkurtra

Neni 2. Objekti

Neni 3. Autoriteti Kompetent

Neni 4. Regjistri Ndërkombëtar

Kapitulli II. Zbatimi dhe regjistrimi ndërkombëtar

Neni 5. Zbatimi

Neni 6. Regjistrimi Ndërkombëtar

Neni 7. Tarifat

Neni 8. Periudha e vlefshmërisë së Regjistrimit Ndërkombëtar

Kapitulli III. Mbrojtja

Neni 9. Përkushtimi ndaj mbrojtjes

Neni 10. Mbrojtja sipas ligjeve të Palëve Kontraktuese dhe instrumenteve të tjera

Neni 11. Mbrojtja në lidhje me emërtimet e regjistruara të origjinës dhe të treguesit gjeografik

Neni 12. Mbrojtja kundër transformimit në kushte të përgjithshme

Neni 13. Masat mbrojtëse në lidhje me të drejtat e tjera

Neni 14. Procedurat e përmbarimit dhe zgjidhjet ligjore

Kapitulli IV. Refuzimi dhe masa të tjera në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar

Neni 15. Refuzimi

Neni 16. Tërheqja e refuzimit

Neni 17. Periudha kalimtare

Neni 18. Njoftimi i dhënies së mbrojtjes

Neni 19. Pavlefshmëria

Neni 20. Ndryshimet dhe zëra të tjerë në Regjistrin Ndërkombëtar

Kapitulli V. Dispozitat administrative

Neni 21. Anëtarësimi në Bashkimin e Lisbonës

Neni 22. Asambleja e Unionit të Posaçëm

Neni 23. [Byroja Ndërkombëtare]

Neni 24. Financimi

Neni 25. Rregulloret

Kapitulli VI. Rishikimi dhe ndryshimi

Neni 26. Rishikimi

Neni 27. Ndryshimi i disa neneve nga Asambleja

Kapitulli VII. Dispozitat përfundimtare

Neni 28. Përfshirja si Palë në këtë Akt

Neni 29. Data e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve

Neni 30. Ndalimi i rezervave

Neni 31. Zbatimi i Marrëveshjes së Lisbonës dhe Aktit të vitit 1967

Neni 32. Anulimi

Neni 33. Gjuhët e këtij Akti; nënshkrimi

Neni 34. Depozitari



KAPITULLI I
HYRJJA DHE DISPOZITA TË
PËRGJITHSHME

Neni 1

Shprehje të shkurtuara

Për qëllimet e këtij Akti, përveç rasteve kur shprehimisht thuhet ndryshe:

i. “Marrëveshja e Lisbonës” nënkupton Marrëveshjen e Lisbonës për Mbrojtjen e Emërtimeve të Origjinës dhe Regjistrimin e tyre Ndërkombëtar, datë 31 tetor 1958;

ii. “Akti 1967” nënkupton Marrëveshjen e Lisbonës, e rishikuar në Stokholm, më 14 korrik 1967, dhe e ndryshuar më 28 shtator 1979;

iii. “ky akt” nënkupton Marrëveshjen e Lisbonës mbi emërtimet e origjinës dhe të treguesit gjeografik, të përcaktuara në këtë Akt;

iv. “Rregullore” nënkupton rregulloret e përmendura në nenin 25;

v. “Konventa e Parisit” nënkupton Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale të 20 marsit 1883, të rishikuar dhe të ndryshuar;

vi. “emërtimi i origjinës” nënkupton një emërtim siç përmendet në nenin 2, paragrafi 1, germa “i”;

vii. “treguesi gjeografik” nënkupton një tregues, siç përmendet në nenin 2, paragrafi 1, germa “ii”;

viii. “Regjistri Ndërkombëtar” nënkupton Regjistrin Ndërkombëtar të mbajtur nga Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me nenin 4, si mbledhje zyrtare e të dhënave në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë, pavarësisht nga mjetet ku ruhen këto të dhëna;

ix. “regjistrim ndërkombëtar” nënkupton një regjistrim ndërkombëtar të regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar;

x. “aplikim” nënkupton një aplikim për regjistrim ndërkombëtar;

xi. “i regjistruar” nënkupton i shënuar në Regjistrin Ndërkombëtar në përputhje me këtë akt;

xii. “zona gjeografike e origjinës” nënkupton një zonë gjeografike, siç përmendet në nenin 2, paragrafi 2;

xiii. “zona gjeografike ndërkufitare” nënkupton një zonë gjeografike që ndodhet në, ose që mbulon, ose pranë Palëve Kontraktuese;

xiv. “Palë Kontraktuese” nënkupton çdo shtet apo organizatë ndërqeveritare që është palë në këtë Akt;

xv. “Palë Kontraktuese e Origjinës” nënkupton Palën Kontraktuese ku ndodhet zona gjeografike e origjinës ose Palët Kontraktuese ku ndodhet zona gjeografike ndërkufitare e origjinës;

xvi. “Autoriteti Kompetent” nënkupton një subjekt të caktuar në përputhje me nenin 3;

xvii. “përfitues” nënkupton personat fizikë ose juridikë që kanë të drejtë sipas ligjit të Palës Kontraktuese të Origjinës të përdorin një emërtim të origjinës ose një tregues gjeografik;

xviii. “organizatë ndërqeveritare” nënkupton një organizatë ndërqeveritare që kualifikohet të bëhet palë e këtij Akti, në përputhje me nenin 28, paragrafi 1, germa “iii”;

xix. “Organizatë” nënkupton Organizatën Botërore të Pronësisë Intelktuale;

xx. “Drejtori i Përgjithshëm” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshëm të Organizatës;

xxi. “Byroja Ndërkombëtare” nënkupton Byronë Ndërkombëtare të Organizatës.

Neni 2

Objekti

1. [Emërtimet e origjinës dhe të treguesit gjeografik] Ky akt zbatohet në lidhje me:

i. çdo emërtim të mbrojtur në Palën Kontraktuese të Origjinës që përbëhet ose përmban emrin e një zone gjeografike ose një emërtim tjetër të njohur se i referohet asaj zone, e cila shërben për të përcaktuar një mall me origjinë në atë zonë gjeografike, ku cilësia ose karakteristikat e atij malli i atribuohen ekskluzivisht ose kryesisht mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrorë dhe njerëzorë dhe që i ka dhënë atij malli reputacionit e tij; si dhe

ii. çdo tregues i mbrojtur në Palën Kontraktuese të Origjinës që përbëhet ose përmban emrin e një zone gjeografike ose një tregues tjetër që njihet se i referohet asaj zone, i cili identifikon origjinën e një malli në atë zonë gjeografike, ku një cilësi, reputacioni apo karakteristikë e caktuar e mallit, i atribuohet origjinës së tij gjeografike.



2. [Zonat e mundshme gjeografike të origjinës] Një zonë gjeografike e origjinës siç përshkruhet në paragrafin 1, mund të përbëhet nga i gjithë territori i Palës Kontraktuese të Origjinës ose një rajon, lokalitet ose vend në Palën Kontraktuese të Origjinës. Kjo nuk përjashton zbatimin e këtij Akti në lidhje me një zonë gjeografike të origjinës, siç përshkruhet në paragrafin 1, e cila përbëhet nga një zonë gjeografike ndërkufitare ose një pjesë e saj.

Neni 3

Autoriteti Kompetent

Çdo Palë Kontraktuese përcakton një subjekt i cili është përgjegjës për administrimin e këtij Akti në territorin e tij dhe për komunikimet me Byronë Ndërkombëtare sipas këtij Akti dhe këtyre Rregulloreve. Pala Kontraktuese njofton emrin dhe të dhënat e kontaktit të këtij Autoriteti Kompetent në Byronë Ndërkombëtare, siç përcaktohet në Rregullore.

Neni 4

Regjistri Ndërkombëtar

Byroja Ndërkombëtare mban një Regjistër Ndërkombëtar ku regjistron Regjistrimet Ndërkombëtare të kryera sipas këtij Akti, sipas Marrëveshjes së Lisbonës dhe Aktit të vitit 1967 ose sipas të dyjave, dhe të dhëna që lidhen me këto regjistrime ndërkombëtare.

KAPITULLI II

ZBATIMI DHE REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 5

Aplikimi

1. [Vendi i regjistrimit] Aplikimet duhet të dorëzohen në Byronë Ndërkombëtare.

2. [Aplikimi i dorëzuar nga Autoriteti Kompetent] Në përputhje me paragrafin 3, aplikimi për regjistrimin ndërkombëtar të një emërtimi të origjinës ose një treguesi gjeografik duhet të depozitohet nga Autoriteti Kompetent në emër të:

i. përfituesit; ose

ii. personit fizik ose personit juridik që ka statusin ligjor sipas ligjit të Palës Kontraktuese të Origjinës për të ushtruar të drejtat e

përfituesve ose të drejta të tjera në emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik.

3. [Aplikimi i depozituar drejtpërdrejt] a) Pa cenuar paragrafin 4, nëse lejohet sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese të Origjinës, aplikimi mund të paraqitet nga përfituesit ose nga personi fizik ose juridik i përmendur në paragrafin 2, germa “i”.

b) Nënparagrafi “a” zbatohet duke qenë objekt i një deklarate të dhënë nga Pala Kontraktuese ku deklarohet se lejohet sipas legjislacionit të saj. Kjo deklaratë mund të bëhet nga Pala Kontraktuese në momentin e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose të aderimit, ose kurdo më vonë. Kur deklarata jepet në momentin e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose të aderimit, ajo hyn në fuqi menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me atë Palë Kontraktuese. Kur deklarata jepet pas hyrjes në fuqi të këtij Akti në lidhje me Palën Kontraktuese, ajo hyn në fuqi tre muaj pas datës kur Drejtori i Përgjithshëm ka marrë deklaratën.

4. [Aplikimi i mundshëm i përbashkët në rastin e një zone gjeografike ndërkufitare] Në rastin e një zone gjeografike të origjinës që përbëhet nga një zonë gjeografike ndërkufitare, Palët Kontraktuese në afërsi, në përputhje me marrëveshjen mes tyre, mund të aplikojnë bashkërisht nëpërmjet një Autoriteti Kompetent të përcaktuar bashkërisht.

5. [Përmbajtja e detyrueshme] Rregulloret duhet të specifikojnë të dhënat e detyrueshme që duhet të përfshihen në aplikim, përveç atyre të specifikuara në nenin 6, paragrafi 3.

6. [Përmbajtja opsionale] Rregulloret mund të specifikojnë të dhënat opsionale që mund të përfshihen në aplikacion.

Neni 6

Regjistrimi Ndërkombëtar

1) [Shqyrtimi formal nga Byroja Ndërkombëtare] Pas marrjes së një kërkesë për regjistrimin ndërkombëtar të emërtimit të origjinës ose të një treguesi gjeografik në formën e duhur, siç është përcaktuar në këto Rregullore, Byroja Ndërkombëtare regjistron emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik në Regjistrin Ndërkombëtar.



2. [Data e Regjistrimit Ndërkombëtar] Në përputhje me paragrafin 3, data e regjistrimit ndërkombëtar është data kur është marrë nga Byroja Ndërkombëtare.

3. [Data e Regjistrimit Ndërkombëtar ku ka mangësi të veçorive] Kur aplikacioni nuk përmban të gjitha të dhënat e mëposhtme:

i. identifikimin e Autoritetit Kompetent ose, në rastin e nenit 5, paragrafi 3, aplikantit ose aplikantëve;

ii. të dhënat që identifikojnë përfituesit dhe, sipas rastit, personin fizik ose personin juridik të përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa “ii”;

iii. emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik për të cilin kërkohet regjistrimi ndërkombëtar;

iv. mallin ose mallrat për të cilat aplikohet emërtimi i origjinës ose treguesi gjeografik;

data e regjistrimit ndërkombëtar është data kur Byroja Ndërkombëtare ka marrë për herë të fundit veçoritë e munguara nga Byroja Ndërkombëtare.

4. [Publikimi dhe njoftimi i regjistrimeve ndërkombëtare] Byroja Ndërkombëtare publikon pa vonesë çdo regjistrim ndërkombëtar dhe njofton Autoritetin Kompetent të çdo Pale Kontraktuese për regjistrimin ndërkombëtar.

5. [Data e hyrjes në fuqi të regjistrimit ndërkombëtar] a) Duke iu nënshtruar nënparagrafit; b), Emërtimi i regjistruar i origjinës ose treguesi gjeografik, në çdo Palë Kontraktuese që nuk ka refuzuar mbrojtjen, në përputhje me nenin 15 ose që ka dërguar në Byronë Ndërkombëtare një njoftim për dhënien e mbrojtjes në përputhje me nenin 18, mbrohet nga data e regjistrimit ndërkombëtar.

b) Pala Kontraktuese, përmes një deklarate, mund të njoftojë drejtorin e përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose rajonal, për faktin që emërtimi i regjistruar i origjinës ose treguesi gjeografik është mbrojtur nga data e përmendur në deklaratë dhe kjo datë nuk duhet të jetë më vonë se data e skadimit të afatit për refuzimin e përcaktuar në këto Rregullore, në përputhje me nenin 15, paragrafi 1, germa “a”.

Neni 7

Tarifat

1. [Tarifa ndërkombëtare e regjistrimit] Regjistrimi ndërkombëtar i çdo emërtimi të origjinës dhe çdo treguesi gjeografik, është objekt i pagesës së tarifës së specifikuar në këto Rregullore.

2. [Tarifat për zërat e tjerë në Regjistrin Ndërkombëtar] Rregulloret përcaktojnë tarifat që duhet të paguhet për regjistrimet e tjera në Regjistrin Ndërkombëtar dhe për furnizimin e ekstrakteve, vërtetimeve ose informacioneve të tjera në lidhje me përmbajtjen e regjistrimit ndërkombëtar.

3. [Reduktimet e tarifave] Tarifat e reduktuara përcaktohen nga Asambleja për disa regjistrime ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës dhe për disa regjistrime ndërkombëtare të treguesve gjeografikë, veçanërisht ato kur Pala Kontraktuese e Origjinës është një vend në zhvillim ose një vend më pak të zhvilluar.

4. [Tarifa individuale] a) Çdo Palë Kontraktuese, përmes një deklarate mund të njoftojë drejtorin e përgjithshëm se mbrojtja që rezulton nga regjistrimi ndërkombëtar përfshihet vetëm nëse paguhet një tarifë për mbulimin e kostove të shqyrtimit thelbësor të regjistrimit ndërkombëtar. Shuma e kësaj tarife individuale shënohet në deklaratë dhe mund të ndryshohet në deklaratat e tjera. Kjo shumë nuk mund të jetë më e lartë sesa e njëjta shumë e kërkuar sipas legjislacionit kombëtar ose rajonal të Palës Kontraktuese, minus kursimet që rrjedhin nga procedura ndërkombëtare. Gjithashtu, çdo Palë Kontraktuese, përmes një deklarate mund të njoftojë drejtorin e përgjithshëm se kërkon një tarifë administrative që përdoruesit të përdorin emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik në atë Palë Kontraktuese.

b) Mospagimi i kësaj tarife individuale, në përputhje me rregulloret, sjell anulimin e mbrojtjes për Palën Kontraktuese që kërkon tarifën.



Neni 8

**Periudha e vlefshmërisë së Regjistrimit
Ndërkombëtar**

1. [Varësia] Regjistrimet ndërkombëtare janë të vlefshme për një kohë të papacaktuar, në kuptimin që mbrojtja e një emërtimi të regjistruar të origjinës ose treguesi gjeografik nuk kërkohet më nëse emri i emërimit të origjinës ose treguesi i treguesit gjeografik nuk është më i mbrojtur në Palën Kontraktuese të Origjinës.

2. [Anulimi] a) Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të Origjinës ose, në rastin e nenit 5, paragrafi 3, përfituesit ose personi fizik ose personi juridik i përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa “ii” ose Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të Origjinës mund të kërkojë në çdo kohë që Byroja Ndërkombëtare të anulojë regjistrimin ndërkombëtar në fjalë.

b) Kur emërtimi që përbën një emërtim të regjistruar të origjinës ose kur treguesi që përbën një tregues të regjistruar gjeografik, nuk është më i mbrojtur në Palën Kontraktuese të Origjinës, Autoriteti Kompetent i Palës Kontraktuese të Origjinës kërkon anulimin e regjistrimit ndërkombëtar.

**KAPITULLI III
MBROJTJA**

Neni 9

Përkushtimi ndaj mbrojtjes

Çdo Palë Kontraktuese mbron emërtimet e regjistruara të origjinës dhe të treguesit gjeografik në territorin e saj, brenda sistemit të vet ligjor dhe sipas praktikës së vet, por në përputhje me kushtet e këtij Akti dhe duke iu nënshtruar çdo refuzimi, heqje dorë, pavlefshmërie ose anulimi që mund të hyjë në fuqi brenda territorit të vet dhe në mirëkuptimin që Palët Kontraktuese që nuk arrijnë të bëjnë dallimin në legjislacionin e tyre kombëtar apo rajonal mes emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë, nuk do t'u kërkohet që ta përfshijnë këtë dallim në legjislacionin e tyre kombëtar dhe rajonal.

Neni 10

**Mbrojtja sipas ligjeve të Palëve
Kontraktuese ose instrumenteve të tjera**

1. [Forma e mbrojtjes ligjore] Secila palë kontraktuese është e lirë të zgjedhë llojin e legjislacionit sipas të cilit vendos mbrojtjen e përcaktuar në këtë akt, me kusht që ky legjislacion të plotësojë kërkesat thelbësore të këtij akti.

2. [Mbrojtja sipas instrumenteve të tjera] Dispozitat e këtij akti nuk prekin në asnjë mënyrë asnjë mbrojtje që mund t'i japë një Palë Kontraktuese në lidhje me emërtimet e regjistruara të origjinës ose të treguesit gjeografik të regjistruar sipas legjislacionit të tij kombëtar ose rajonal ose sipas instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

3. [Marrëdhënia me instrumentet e tjera] Asgjë në këtë akt nuk derogon nga asnjë detyrim që Palët Kontraktuese i detyrohen njëra-tjetrës sipas çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar dhe as nuk cenon ndonjë të drejtë që Pala Kontraktuese gëzon sipas ndonjë instrumenti tjetër ndërkombëtar.

Neni 11

**Mbrojtja në lidhje me emërtimet e
regjistruara të origjinës dhe të treguesit
gjeografik**

1. [Përmbajtja e mbrojtjes] Duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Akti, në lidhje me emërtimin e regjistruar të origjinës ose një tregues të regjistruar gjeografik, çdo Palë Kontraktuese garanton mjetet ligjore për të parandaluar:

a) Përdorimin e emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik:

i. në lidhje me mallrat e të njëjtit lloj, si p.sh., ato për të cilat aplikohet emërtimi i origjinës ose të treguesi gjeografik, që nuk burojnë nga zona gjeografike e origjinës ose që nuk plotësojnë kërkesat e tjera të zbatueshme për përdorimin e emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik;

ii. në lidhje me mallrat që e llojeve të ndryshme krahasuar me ato për të cilat aplikohet emërtimi i origjinës ose të treguesi gjeografik ose shërbimet, nëse ky përdorim tregon ose sugjeron ndonjë lidhje mes këtyre mallrave ose shërbimeve dhe përfituesve të emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik dhe ka gjasa të dëmtojë interesat e tyre ose, sipas rastit, për shkak të



reputacionit të emërimit të origjinës ose treguesit gjeografik në Palën Kontraktuese në fjalë, ky përdorimi ka gjasë të dëmtojë ose të qarkullojë në mënyrë të padrejtë ose të përfitojë padrejtësisht nga ky reputacion;

b) Çdo praktikë tjetër që mund të çorientojë konsumatorët në lidhje me origjinën, prejardhjen ose natyrën e vërtetë të mallrave.

2. [Përmbajtja e mbrojtjes në lidhje me disa përdorime] paragrafi 1, germa “a”, zbatohet, gjithashtu, për përdorimin e emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik në shumën e imitimit të tij edhe nëse shënohet origjina e vërtetë e mallrave ose nëse emërtimi i origjinës ose të treguesit gjeografik përdoret i përkthyer ose shoqërohet me terma të tillë si: “stili”, “lloji”, “natyra”, “mënyra”, “imitimi”, “metoda”, “prodhuar në” “i ngjashëm” të ngjashme “ose terma të tjerë të ngjashëm”¹.

3. [Përdorimi në markë tregtare] Pa cenuar nenin 13, paragrafi 1, një Palë Kontraktuese, në formë *ex officio*, nëse lejohet sipas legjislacionit të saj ose me kërkesë të një pale të interesuar, refuzon ose shfuqizon regjistrimin e markës së dytë nëse përdorimi i markës tregtare shkakton një nga situatat e parashikuara në paragrafin 1.

Neni 12

Mbrojtja kundër transformimit në kushte të përgjithshme

Duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Akti, emërtimet e regjistruara të origjinës dhe të treguesit gjeografik të regjistruar nuk mund të konsiderohen si gjenerikë² nga Pala Kontraktuese.

¹ Deklaratë e miratuar lidhur me nenin 11, paragrafi 2: Për qëllimet e këtij akti nënkuptohet që kur disa elemente të emërimit ose të treguesit që përbëjnë emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik kanë një karakter gjenerik në Palën Kontraktuese të Origjinës, mbrojtja e tyre sipas këtij paragrafi nuk kërkohet nga Palët e tjera Kontraktuese. Për më shumë siguri, refuzimi ose pavlefshmëria e markës tregtare ose zbulimi i shkeljeve të Palëve Kontraktuese sipas kushteve të nenit 11, nuk mund të bazohet në komponentët që kanë karakter gjenerik.

² Deklaratë e miratuar lidhur me nenin 12: Për qëllimet e këtij Akti, nënkuptohet që neni 12 nuk cenon zbatimin e dispozitave të këtij Akti në lidhje me përdorimin e mëparshëm, pasi, përpara regjistrimit ndërkombëtar, emërtimi ose treguesi që përbën emërtimin e origjinës ose treguesin gjeografik mund të jetë gjenerik në një Palë Kontraktuese, përveç Palës Kontraktuese të Origjinës, pjesërisht ose tërësisht, për shembull, për shkak se emërtimi ose treguesi, ose një pjesë e tij, është identik me termin që përdoret në gjuhën e përbashkët njëjloj emri i zakonshëm i mallit ose shërbimit të kësaj Pale Kontraktuese, ose është identik me emrin e zakonshëm të një varieteti të rrushit në këtë Palë Kontraktuese.

Neni 13

Masat mbrojtëse në lidhje me të drejtat e tjera

1. [Të drejtat e një marke tregtare të mëparshme] Dispozitat e këtij Akti nuk cenojnë markën tregtare të mëparshme të aplikuar ose të regjistruar në mirëbesim ose të fituar nëpërmjet përdorimit në mirëbesim, nga një Palë Kontraktuese. Kur ligji i një Pale Kontraktuese parashikon një përjashtim të kufizuar ndaj të drejtave të dhëna nga një markë tregtare deri në masën që marka tregtare e mëparshme në rrethana të caktuara mund të mos i japë të drejtë zotëruesit të saj të parandalojë dhënien e mbrojtjes së emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik ose përdorimin e tyre nga ajo Palë Kontraktuese, mbrojtja e emërimit të regjistruar të origjinës ose të treguesit gjeografik nuk kufizon në asnjë mënyrë të drejtat e dhëna nga ajo markë tregtare.

2. [Emri personal i përdorur në biznes] Dispozitat e këtij Akti nuk cenojnë të drejtën e çdo personi për të përdorur, gjatë tregtisë, emrin e personit ose emrin e paraardhësit të atij personi në biznes, përveç rasteve kur ky emër është përdorur për të mashtruar publikun.

3. [Të drejtat e bazuara në varietetin e bimëve ose emërtimin e racave të kafshëve] Dispozitat e këtij Akti nuk cenojnë të drejtën e çdo personi për të përdorur një varietet të bimëve ose emërtimin e racave të kafshëve gjatë tregtisë, përveç rasteve kur këto varietete të bimëve ose emërtimi i racave të kafshëve janë përdorur për të mashtruar publikun.

4. [Masat mbrojtëse në rastin e njoftimit të tërheqjes së refuzimit ose të dhënies së mbrojtjes] Kur një Palë Kontraktuese që ka refuzuar efektet e regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 15, mbi bazën e përdorimit sipas një marke tregtare të mëparshme ose të drejtave të tjera, siç përmendet në këtë nen, njofton tërheqjen e atij refuzimi sipas nenit 16 ose jep mbrojtjen sipas nenit 18, mbrojtja e dhënë e emërimit të origjinës ose të treguesit gjeografik nuk e cenon këtë të drejtë ose përdorimin e saj, përveç nëse kjo mbrojtje jepet pas anulimit, mosrinnovimit, revokimit ose shfuqizimit të kësaj të drejte.



Neni 14

Procedurat e përmbarimit dhe zgjidhjet ligjore

Secila Palë Kontraktuese vendos në dispozicion mjete efektive ligjore për mbrojtjen e emërtimeve të regjistruara të origjinës dhe treguesve gjeografikë të regjistruar dhe garanton që procedurat ligjore për sigurimin e mbrojtjes së tyre të mund të vendosen në dispozicion nga një autoritet publik ose nga ndonjë palë e interesuar, qoftë person fizik ose person juridik apo ent publik apo privat, në varësi të sistemit dhe praktikave e tij ligjore.

KAPITULLI IV

REFUZIMI DHE MASA TË TJERA NË LIDHJE ME REGJISTRIMET NDËRKOMBËTARE

Neni 15

Refuzimi

1. [Refuzimi i efekteve të regjistrimit ndërkombëtar] a) Brenda afatit kohor të përcaktuar në këto Rregullore, Autoriteti Kompetent i një Pale Kontraktuese mund të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për refuzimin e efekteve të një regjistrimi ndërkombëtar në territorin e tij. Njoftimi i këtij refuzimi mund të bëhet nga Autoriteti Kompetent *ex officio*, nëse lejohet me ligj ose me kërkesë të një pale të interesuar.

b) Njoftimi për refuzimin duhet të përcaktojë arsyet ku bazohet ky refuzim.

2. [Mbrojtja sipas instrumenteve të tjera] Njoftimi për refuzimin nuk do të dëmtojë asnjë mbrojtje tjetër që mund të jetë e disponueshme, në përputhje me nenin 10, paragrafi 2, për emërtimin ose treguesin në fjalë të Palës Kontraktuese, me të cilën lidhet ky refuzim.

3. [Detyrimi për të ofruar mundësi për palët e interesuara] Secila Palë Kontraktuese ofron një mundësi të arsyeshme, për këto që mund t'i preken interesuar nga një regjistrim ndërkombëtar, për t'i kërkuar Autoritetit Kompetent të njoftojë refuzimin për regjistrimin ndërkombëtar.

4. [Regjistrimi, publikimi dhe komunikimi i refuzimeve] Byroja Ndërkombëtare regjistron refuzimin dhe arsyet për këtë refuzim në

Regjistrin Ndërkombëtar. Ajo publikon refuzimin dhe arsyet për refuzimin dhe i përcjell Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të Origjinës njoftimin e refuzimit ose, kur aplikimi është depozituar drejtpërdrejt në përputhje me nenin 5, paragrafi 3, përfituesit ose personit fizik ose personit juridik të përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa “i” dhe Autoritetit Kompetent të Palës Kontraktuese të Origjinës.

5. [Trajtimi kombëtar] Secila Palë Kontraktuese vendos në dispozicion të palëve të interesuara të prekura nga ky refuzim të njëjtat mjete ligjore dhe administrative që janë në dispozicion të shtetasve të vet, në lidhje me refuzimin e mbrojtjes së një emërtimi të origjinës ose një treguesi gjeografik.

Neni 16

Tërheqja e refuzimit

Refuzimi mund të tërhiqet në përputhje me procedurat e përcaktuara në këto Rregullore. Kjo tërheqje regjistrohet në Regjistrin Ndërkombëtar.

Neni 17

Periudha kalimtare

1. [Opsioni për dhënien e periudhës kalimtare] Pa cenuar nenin 13, kur një Palë Kontraktuese nuk ka refuzuar efektet e një regjistrimi ndërkombëtar mbi bazën e përdorimit paraprak nga një palë e tretë ose ka tërhequr këtë refuzim ose ka njoftuar dhënien e mbrojtjes, ajo mund të lejojë, nëse lejohet me ligj, të japë një periudhë të caktuar, siç përcaktohet në këto Rregullore, për ndërprerjen e këtij përdorimi.

2. [Njoftimi i periudhës kalimtare] Pala Kontraktuese njofton Byronë Ndërkombëtare për çdo periudhë të tillë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këto Rregullore.

Neni 18

Njoftimi i dhënies së mbrojtjes

Autoriteti Kompetent i një Pale Kontraktuese mund të njoftojë Byronë Ndërkombëtare për dhënien e mbrojtjes së një emërtimi të regjistruar të origjinës ose treguesi gjeografik. Byroja Ndërkombëtare regjistron çdo njoftim të tillë në Regjistrin Ndërkombëtar dhe e publikon atë.



Neni 19

Pavlefshmëria

1. [Mundësia për mbrojtjen e të drejtave] Pavlefshmëria e efekteve, pjesërisht ose tërësisht, të një regjistrimi ndërkombëtar në territorin e një Pale Kontraktuese mund të shpallet vetëm pasi t'u ketë dhënë përfituesve mundësinë për të mbrojtur të drejtat e tyre. Kjo mundësi i jepet personit fizik ose personit juridik të përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa “ii”.

2. [Njoftimi, regjistrimi dhe publikimi] Pala Kontraktuese njofton pavlefshmërinë e efekteve të një regjistrimi ndërkombëtar në Byronë Ndërkombëtare, e cila regjistron pavlefshmërinë në Regjistrin Ndërkombëtar dhe e publikon atë.

3. [Mbrojtja sipas instrumenteve të tjera] Pavlefshmëria nuk do të dëmtojë asnjë mbrojtje tjetër të vendosur në dispozicion në përputhje me nenin 10, paragrafi 2, për emërtimin ose treguesin në fjalë të Palës Kontraktuese që shpalli të pavlefshëm efektet e regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 20

Ndryshimet dhe zëra të tjerë në Regjistrin Ndërkombëtar

Procedurat për modifikimin e regjistrimeve ndërkombëtare dhe regjistrimeve të tjera në Regjistrin Ndërkombëtar duhet të specifikohen në këto Rregullore.

KAPITULLI V

DISPOZITAT ADMINISTRATIVE

Neni 21

Anëtarësimi në Unionin e Lisbonës

Palët Kontraktuese janë anëtare të të njëjtit Union të Posaçëm si shtetet palë në Marrëveshjen e Lisbonës ose Aktin e 1967-ës, pavarësisht nëse janë ose nuk janë palë në Marrëveshjen e Lisbonës ose në Aktin e 1967-ës.

Neni 22

Asambleja e Unionit të Posaçëm

1. [Përbërja] a) Palët Kontraktuese janë anëtare të së njëjtës Asamble si shtetet palë në Aktin e 1967-ës.

b) Secila Palë Kontraktuese përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.

c) Çdo delegacion mbulon shpenzimet e veta.

2. [Detyrat] a) Asambleja:

i. trajton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e këtij akti;

ii. i jep drejtorit të përgjithshëm udhëzime në lidhje me përgatitjen e konferencave të rishikimit të përmendura në nenin 26, paragrafi 1, me vëmendje të veçantë për çdo koment të bërë nga ata anëtarë të Unionit të Posaçëm që nuk kanë ratifikuar apo aderuar këtë akt;

iii. ndryshon këto Rregullore;

iv. shqyrton dhe miraton raportet dhe veprimtaritë e drejtorit të përgjithshëm lidhur me Unionin e Posaçëm dhe i jep atij ose asaj të gjitha udhëzimet e nevojshme në lidhje me çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;

v. përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm dhe miraton llogaritë e tij përfundimtare;

vi. miraton Rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;

vii. krijon komitete dhe grupe pune, siç mund ta konsiderojë të përshtatshme për të përmbushur objektivat e Unionit të Posaçëm;

viii. përcakton cilat shtete, organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare do të pranohen në mbledhjet e tyre si vëzhgues;

ix. miraton ndryshime në nenet 22 deri në 24 dhe 27;

x. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të Unionit të Posaçëm dhe kryerjen çdo funksioni tjetër sipas këtij akti.

b) Në lidhje me çështjet me interes edhe për sindikatat e tjera nën administrimin e Organizatës, Asambleja merr vendimet e tij, pasi të ketë dëgjuar këshillën e Komitetit Koordinues të Organizatës.

3. [Kuorumi] a) Gjysma e anëtarëve të Asamblesë që kanë të drejtën e votës për një çështje të caktuar përbëjnë një kuorum për qëllimet e votimit për atë çështje.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit “a”, nëse në çdo seancë numri i anëtarëve të Asamblesë që janë shtete, kanë të drejtën e



votës për një çështje të caktuar dhe përfaqësohen me më pak se gjysmën, por të barabartë ose mbi se një e treta e anëtarëve të Asamblesë që janë shtete dhe kanë të drejtë të votojnë për çështje, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me procedurën e vet, të gjitha këto vendime do të hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare ua komunikon këto vendime anëtarëve të Asamblesë që janë shtete, që kanë të drejtën e votës për atë çështje të caktuar dhe që nuk janë të përfaqësuara dhe i fton ato të hedhin me shkrim votën e tyre ose të abstenojnë brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i këtyre anëtarëve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar, në këtë mënyrë arrin numrin e anëtarëve që mungonin për arritjen e kuorumit në seancë, këto vendimet hyjnë në fuqi me kusht që në të njëjtën kohë të fitohet shumica e nevojshme.

4. [Marrja e vendimeve në Asamble] a) Asambleja duhet të përpaket të marrë vendimet e saj me konsensus.

b) Kur një vendim nuk mund të arrihet me konsensus, çështja në fjalë vendoset me votim. Në këtë rast,

i. çdo Palë Kontraktuese që është shtet ka një votë dhe voton vetëm në emër të vet; dhe

ii. çdo Palë Kontraktuese që është organizatë ndërqeveritare mund të votojë, në vend të shteteve të veta anëtar, me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të saj që janë palë në këtë Akt. Asnjë nga këto organizata ndërqeveritare nuk merr pjesë në votim nëse ndonjëri prej shteteve anëtare të saj ushtron të drejtën e tij të votës dhe anasjelltas.

c) Për çështjet që lidhen vetëm me shtetet që kanë detyrime sipas Aktit të 1967-ës, Palët Kontraktuese që nuk kanë detyrime sipas Aktit të 1967-ës nuk gëzojnë të drejtën e votës, ndërsa për çështjet që lidhen vetëm me Palët Kontraktuese, vetëm këto të fundit gëzojnë të drejtën e votës.

5. [Shumica] a) Në varësi të dispozitave të nenit 27, paragrafi 2, dhe 27, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.

b) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

6. [Seancat] a) Asambleja mbledhet pas thirrjes nga drejtori i përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.

b) Asambleja mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e drejtorit të përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së anëtarëve të Asamblesë ose me iniciativën e vetë drejtorit të përgjithshëm.

c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga drejtori i përgjithshëm.

7. [Procedura] Procedura Asambleja miraton vetë rregulloren e saj të brendshme.

Neni 23

[Byroja Ndërkombëtare]

1. [Detyra administrative] a) Regjistrimi ndërkombëtar dhe detyrat përkatëse, si dhe të gjitha detyrat e tjera administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm, kryhen nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe siguron sekretariatit e Asamblesë dhe të këtyre komiteteve dhe grupeve të punës, siç është përcaktuar nga Asambleja.

c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.

2. [Roli i Byrosë Ndërkombëtare në Asamble dhe në takime të tjera] Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit i caktuar prej tij merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, komiteteve dhe grupeve të punës të krijuara nga Asambleja. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij është sekretar *ex officio* i këtyre organeve.

3. [Konferencat] a) Byroja Ndërkombëtare përgatit konferencat e rishikimit sipas direktivave të Asamblesë.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare dhe kombëtare joqeveritare në lidhje me këto përgatitje në fjalë.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e mbajtura në këto konferenca.



4. [Detyra të tjera] Detyrat Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar në lidhje me këtë akt.

Neni 24 Financat

1. [Buxheti] Të ardhurat dhe shpenzimet e Unionit të Posaçëm pasqyrohen në buxhetin e Organizatës në mënyrë të drejtë dhe transparente.

2. [Burimet e financimit të buxhetit] Të ardhurat e Unionit të Posaçëm financohen nga burimet e mëposhtme:

i. tarifatat e mbledhura sipas nenit 7, paragrafi 1 dhe 2;

ii. të ardhurat nga shitja e, ose honorarët nga botimet e Byrosë Ndërkombëtare;

iii. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;

iv. qiratë, të ardhura nga investimet dhe të ardhura të tjera të ndryshme;

v. kontributet e veçanta të Palëve Kontraktuese ose çdo burim alternativ që rrjedh nga Palët Kontraktuese ose përfuturit, ose të dyja, nëse dhe deri në masën që të ardhurat nga burimet e shënuara në pikat “i” deri në “iv” nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet, siç është vendosur nga Asambleja.

3. [Përcaktimi i tarifave; niveli i buxhetit] a) Shumat e tarifave të përmendura në paragrafin 2 përcaktohen nga Asambleja me propozimin e drejtorit të përgjithshëm dhe përcaktohen në mënyrë të tillë që, së bashku me të ardhurat e grumbulluara nga burime të tjera sipas paragrafit 2, të ardhurat e Unionit të Posaçëm duhet, në rrethana normale, të jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e Byrosë Ndërkombëtare për mbajtjen e shërbimit të regjistrimit ndërkombëtar.

b) Nëse programi dhe buxheti i Organizatës nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, autorizimi i dhënë për Drejtorin e Përgjithshëm për nxjerrjen e detyrimeve dhe kryerjen e pagesave duhet të jetë i njëjtë me nivelin e periudhës financiare të mëparshme.

4. [Përcaktimi i kontributeve të veçanta të përmendura në paragrafin 2, germa “v”] Me qëllim përcaktimit të kontributit të saj, çdo Palë Kontraktuese i përket së njëjtës klasë që i përket në kontekstin e Konventës së Parisit ose, nëse nuk është një Palë Kontraktuese në

Konventën e Parisit, ashtu siç do t'i përkiste nëse do të kishte qenë Palë Kontraktuese e Konventës së Parisit. Organizatat ndërqeveritare konsiderohen se i përkasin klasës së kontributit I (një), përveç nëse vendoset unanimisht ndryshe nga Asambleja. Kontributi ponderohet pjesërisht sipas numrit të regjistrimeve që rrjedhin nga Pala Kontraktuese, siç vendoset nga Asambleja.

5. [Fondi i kapitalit qarkullues] Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga pagesat e kryera paraprakisht nga secili anëtar i Unionit të Posaçëm në momentin ku vendoset nga ky Union i Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja mund të vendosë ta rrisë atë. Raporti dhe kushtet e pagesës caktohen nga Asambleja me propozim të drejtorit të përgjithshëm. Nëse Unioni i Posaçëm regjistron të ardhura të tepërta mbi shpenzimet në çdo periudhë financiare, tepërat e fondit kapital qarkullues mund t'i kthehen secilit anëtar në përpjesëtim me pagesat e tyre fillestare, me propozim të drejtorit të përgjithshëm dhe sipas vendimit të Asamblesë.

6. [Pagesat paraprake nga shteti pritës] a) Në marrëveshjen për selinë të nënshkruar me shtetin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që, sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky shtet duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, midis këtij shteti dhe Organizatës.

b) Shteti i përmendur në nënparagrafin “a” dhe Organizata kanë të drejtë të prishin detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, përmes një njoftimi shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

7. [Auditimi i llogarive] Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë shtete anëtarë të Unionit të Posaçëm ose nga auditorë të jashtëm, siç parashikohet në Rregulloret Financiare të Organizatës. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.



Neni 25

Rregulloret

1. [Objekti] Detajet për zbatimin e këtij akti përcaktohen në këto Rregulloret.

2. [Ndryshimi i disa dispozitave të rregullores] a) Asambleja mund të vendosë që disa dispozita të caktuara të Rregulloreve të mund të ndryshohen vetëm me unanimitet ose vetëm nga një shumicë prej tre të katërtave.

b) Në mënyrë që kërkesa për unanimitet ose shumicën tre të katërtave të mos aplikohet më në të ardhmen për ndryshimin e një dispozite të këtyre Rregulloreve, kërkohet unanimitet.

c) Në mënyrë që kërkesa për unanimitet ose shumicën e tre të katërtave të aplikohet në të ardhmen për ndryshimin e një dispozite të këtyre Rregulloreve, kërkohet shumica e tre të katërtave të votave.

3. [Konflikti mes këtij akti dhe Rregulloreve] Në rastin e ndonjë konflikti mes dispozitave të këtij akti dhe dispozitave të këtyre Rregulloreve, do të mbizotërojnë dispozitat e këtij akti.

KAPITULLI VI

RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

Neni 26

Rishikimi

1. [Konferencat e rishikimit] Ky akt mund të rishikohet nga Konferencat Diplomatieke të Palëve Kontraktuese. Për thirrjen e çdo Conference Diplomatieke vendos Asambleja.

2. [Rishikimi i ndryshimeve të disa neneve] nenet 22 deri në 24 dhe 27 mund të ndryshohen përmes një konference rishikimi ose nga Asambleja, në përputhje me dispozitat e nenit 27.

Neni 27

Ndryshimi i disa neneve nga Asambleja

1. [Propozimet për ndryshime] a) Propozimet për ndryshimin e neneve 22 deri në 24 dhe të këtij neni, mund të iniciohen nga Pala Kontraktuese ose nga drejtori i përgjithshëm.

b) Drejtori i përgjithshëm u komunikon këto propozime Palëve Kontraktuese, të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. [Shumica] Miratimi i çdo ndryshimi të neneve të përmendura në paragrafin 1 kërkon

një shumicë prej tre të katërtave, me përjashtim të faktit që miratimi i çdo ndryshimi të nenit 22 dhe të këtij paragrafi kërkon shumicën e katër të pestave.

3. [Hyrja në fuqi] a) Me përjashtim të rasteve kur aplikohet nënparagrafi “b”, çdo ndryshim i neneve, në përputhje me paragrafin 1, hyn në fuqi një muaj pas pranimit me shkrim, në përputhje me proceset kushtetuese përkatëse. 3/4 e vendeve Palë Kontraktuese të cilat janë anëtare të Asamblesë dhe kanë të drejtë vote për ndryshim, depozitojnë te drejtori i përgjithshëm këtë ndryshim.

b) Çdo ndryshim i nenit 22, paragrafi 3 ose 4 ose i këtij nënparagrafi nuk hyn në fuqi nëse, brenda gjashtë muajve nga miratimi i tij nga Asambleja, çdo Palë Kontraktuese njofton drejtorin e përgjithshëm se nuk e pranon një këtë ndryshim.

c) Çdo ndryshim që hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi detyron të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që janë Palë Kontraktuese në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimit ose që bëhen Palë Kontraktuese në një datë të mëvonshme.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Përfshirja si Palë në këtë akt

1. [Kualifikimi] Në varësi të nenit 29 dhe paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni:

i. çdo shtet që është palë në Konventën e Parisit mund të nënshkruajë dhe të bëhet palë në këtë akt;

ii. çdo shtet tjetër anëtar i Organizatës mund të nënshkruajë dhe të bëhet palë e këtij akti nëse deklaron që legjislacioni i tij është në përputhje me dispozitat e Konventës së Parisit në lidhje me emërtimet e origjinës, treguesit gjeografikë dhe markat tregtare;

iii. çdo organizatë ndërqeveritare mund të nënshkruajë dhe të bëhet palë e këtij Akti, me kusht që të paktën një shtet anëtar i asaj organizate ndërqeveritare të jetë palë në Konventën e Parisit dhe me kusht që organizata ndërqeveritare të deklarojë se është autorizuar,



siç duhet, në përputhje me procedurat e saj të brendshme për t'u bërë palë e këtij Akti dhe që, sipas traktatit kushtetues të organizatës ndërqeveritare, të zbatohet legjislacioni sipas të cilit të mund të merren tituj rajonalë të mbrojtjes në lidhje me treguesit gjeografikë.

2. [Ratifikimi ose aderimi] Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare e përmendur në paragrafin 1 mund të depozitojë:

- i. një instrument ratifikimi, nëse e ka nënshkruar këtë Akt; ose
- ii. një instrument aderimi, nëse nuk e ka nënshkruar këtë Akt.

3. [Data e hyrjes në fuqi të depozitimit] a) Duke iu nënshtruar nënparagrafit “b”, data e hyrjes në fuqi të depozitimit të një instrumenti ratifikimi ose aderimi është data kur depozitohet ky instrument.

b) Data e hyrjes në fuqi të depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose të aderimit të cilitdo shteti që është shtet anëtar i një organizate ndërqeveritare dhe për të cilin mbrojtja e emërtimeve të origjinës ose treguesve gjeografikë mund të merret vetëm në bazë të legjislacionit të zbatueshëm mes shteteve anëtare të organizatës ndërqeveritare, është data kur depozitohet instrumenti i ratifikimit ose i aderimit të asaj organizate ndërqeveritare, nëse kjo datë është më vonë se data kur është depozituar instrumenti i shtetit të lartpërmendur. Megjithatë, ky nënparagraf nuk zbatohet në lidhje me shtetet që janë palë e Marrëveshjes së Lisbonës ose Aktit të 1967-ës dhe nuk cenon zbatimin e nenit 31 në lidhje me këto shtete.

Neni 29

Data e hyrjes në fuqi të ratifikimeve dhe aderimeve

1. [Instrumentet që merren në konsideratë] Për qëllimet e këtij neni do të merren në konsideratë vetëm instrumentet e ratifikimit ose të aderimit të depozituara nga shtetet ose organizatat ndërqeveritare të përmendura në nenin 28, paragrafi 1 dhe që data e hyrjes në fuqi është sipas nenit 28, paragrafi 3.

2. [Hyrja në fuqi e këtij Akti] Ky Akt hyn në fuqi tre muaj pasi pesë palë të kualifikuara të përmendura në nenin 28 të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit.

3. [Hyrja në fuqi e ratifikimeve dhe aderimeve] a) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që ka depozituar instrumentin e vet të ratifikimit ose të aderimit tre muaj ose më shumë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij Akti, i lind detyrimi nga ky Akt në datën e hyrjes në fuqi të këtij Akti.

b) Çdo shtet tjetër ose organizatë ndërqeveritare i lind detyrimi nga ky Akt tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentin e tij të ratifikimit ose të aderimit ose në çdo datë të mëvonshme të shënuar në atë instrument.

4. [Regjistrimet ndërkombëtare në fuqi përpara aderimit] Në territorin e shtetit aderues dhe, kur Pala Kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare, në territorin ku zbatohet traktati kushtetues i asaj organizate ndërqeveritare, dispozitat e këtij Akti zbatohen për emërtimet të origjinës dhe treguesit gjeografik të regjistruar më parë sipas këtij Akti në momentin e hyrjes në fuqi të këtij aderimi, në përputhje me nenin 7, paragrafi 4, si dhe dispozitat e kapitullit IV, të cilat zbatohen *mutatis mutandis*. Shteti aderues ose organizata ndërqeveritare mund të specifikojë, në një deklaratë bashkëngjitur instrumentit të saj të ratifikimit ose të aderimit, zgjatjen e afatit kohor të përmendur në nenin 15, paragrafi 1 dhe periodhat e përmendura në nenin 17, në përputhje me procedurat e specifikuar në këto Rregullore në këtë drejtim.

Neni 30

Ndalimi i rezervave

Nuk lejohet asnjë rezervë ndaj këtij akti.

Neni 31

Zbatimi i Marrëveshjes së Lisbonës dhe i aktit të vitit 1967

1. [Marrëdhëniet mes shteteve palë në këtë akt dhe në Marrëveshjen e Lisbonës ose në aktin e 1967-ës] Vetëm ky akt vlen për marrëdhëniet reciproke të shteteve palë në këtë akt dhe në Marrëveshjen e Lisbonës ose Aktin e 1967-ës. Megjithatë, në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në fuqi sipas Marrëveshjes së Lisbonës ose Aktit të 1967-ës, shtetet nuk duhet të japin nivel më të ulët mbrojtjeje se sa kërkohet nga Marrëveshja e Lisbonës ose Akti i 1967-ës.

2. [Marrëdhëniet ndërmjet shteteve palë në këtë akt dhe në Marrëveshjen e Lisbonës ose në Aktin e



1967-ës dhe shtetet palë në Marrëveshjen e Lisbonës ose në Aktin e 1967-ës pa qenë pjesë e këtij akti] Çdo shtet Palë në këtë akt dhe në Marrëveshjen e Lisbonës ose në Aktin e 1967-ës do të vazhdojë të zbatojë Marrëveshjen e Lisbonës ose Aktin e 1967-ës, sipas rastit, në marrëdhëniet e saj me shtetet palë të Marrëveshjes së Lisbonës ose të Akut të 1967-ës që nuk bëjnë pjesë në këtë akt.

Neni 32

Anulimi

1. [Njoftimi] Çdo Palë Kontraktuese mund ta anulojë këtë akt me anë të një njoftimi drejtuar drejtorit të përgjithshëm.

2. [Data e hyrjes në fuqi] Anulimi hyn në fuqi një vit pas datës kur drejtori i përgjithshëm merr njoftimin ose në çdo datë të mëvonshme të shënuar në njoftim. Kjo nuk ndikon zbatimin e këtij Akti për çdo kërkesë në pritje dhe çdo regjistrim ndërkombëtar në fuqi në lidhje me Palën Kontraktuese që anulon, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij anulimi.

Neni 33

Gjuhët e këtij akti; nënshkrimi

1. [Tekstet origjinale; tekste zyrtare] a) Ky akt nënshkruhet në një kopje origjinale të vetme në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, dhe të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

b) Tekstet zyrtare përcaktohen nga drejtori i përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera siç përcaktohen nga Asambleja.

2. [Afati kohor për nënshkrimin] Ky akt mbetet i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës për një vit pas miratimit të tij.

Neni 34

Depozitari

Drejtori i përgjithshëm është depozitari i këtij akti.

VENDIM

Nr. 106/2018

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 18, të ligjit nr. 10 242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Konferencës së Rektorëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Z. Alfred Lako zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmi në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Miraturar në datën 11.10.2018

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë